

NJË BOTË MË E MIRË ËSHTË E MUNDUR



Gabriele Nissim

Themelues dhe president
i Gariwo
Gardens of the Righteous
Worldwide – Milano

Mund të duket utopike, por përballë sfidave të ditëve të sotme (kriza e demokracisë, dhuna, mohimi, konfliktet dhe kriza e planetit tonë të brishtë) duhet të luftojmë urrejtjen në botë.

Me anë të sjelljeve, veprimeve dhe zgjedhjeve të tyre, të Drejtët na mësojnë se kjo gjë është gjithmonë e mundur. Të kujtosh sot të Drejtët e së shkuarës dhe ata të së tashmes nuk do të thotë të nxjerrësh në pah të këqijat që bëhen por të mirat e mundshme, duke treguar kështu se secili prej nesh duke marrë shembull nga këto histori, në mënyrën tonë mund të bëjë gjithmonë një zgjedhje dhe të përmirësojë botën.

Kjo do të thotë që të gjithë ne, ashtu siç na mësojnë të Drejtët, mund të bëhemi kujdestarë të njerëzimit. Për këtë arsye së bashku me historitë e të Drejtëve duhet të risjellim në vëmendje fjalët të rëndësishme për të ndërtuar një të ardhme plot shpresë si: demokracia, dialogu, përfshirja, pluraliteti, paqja, lufta ndaj dhunës. Prandaj ju falënderoj të gjithëve për punën tuaj të palodhshme nëpër këto Kopshte dhe në përhapjen e mesazhit të të Drejtëve.

01

EMRI I PRESIDENTIT IBRAHIM RUGOVA GDHENDET NË KOPSHTIN E TË DREJTËVE

I drejti i vitit



Në Kopshtin e Të Drejtëve në Kampusin Spitalor dhe Universitar Zoja e Këshillit të Mirë u gdhend emri i Të Drejt të vitit 2025. Emri i Presidentit Ibrahim Rugova u zbulua gjatë një ceremonie solemne, gjatë të cilës shumë të pranishëm, personalitete, diplomatë dhe trupa akademike e UKZKM nderuan kontributin e Presidentit të Parë të Kosovës dhe historinë e vyer të veprës së tij domethënëse. Presidenti i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë **fr. Ruggero Valentini** ftoi Ambasadorin e Kosovës në Shqipëri, **SH.T Skënder Durmishi** të zbulonte emrin e Presidentit Rugova, mbuluar me flamurin e Bashkimit Evropian që do të qëndrojë i gdhendur në Kopshtin e të Drejtëve, si simbol i paqes dhe i dialogut.

Ibrahim Rugova ishte një politikan shumëdimensional, me kulturë të gjerë dhe me qasje paqësore në luftën për pavarësi të Kosovës. Këtë vlerë të çmuar të veprës së tij e risolli në vëmendje edhe Presidenti i Akademisë Papnore për Jetën **Monsinjur Vincenzo Paglia**, i cili jo vetëm kujtoi takimet e tij me Presidentin Rugova, por edhe u kujtoi të pranishmëve të shumtë, mes tyre edhe shumë të rinj studentë, fjalët e shkrimtarit Ismail Kadare që e quante Rugovën një "Kolos të brishtë të Kosovës".

Rugova mori përgjegjësinë, tha Monsinjur Paglia që të përfaqësonte popullin

vijon në faqen 2



MINISTRI SCHILLACI VIZITON KAMPUSIN TONË

Një mysafir i shquar dhe i rëndësishëm



Kampusi Universitar dhe Spitalor Zoja e Këshillit të Mirë u vizitua nga Ministri italian i Shëndetësisë, i nderuari **Prof. Orazio Schillaci**. Ministri shoqërohej nga Ambasadori italian i akredituar në Shqipëri Marco Alberti dhe Zv. Ministri shqiptare e Shëndetësisë Entela Ramosaçaj.

Ministri Schillaci u prit në këtë vizitë zyrtare nga Presidenti i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë fr. Ruggero Valentini, Rectori i UKZKM Prof. Leonardo Palombi, Zv. Rectori Prof. Edmond Hajdëri, Drejtori i Spitalit Katolik fr. Natalino Poggi, Drejtori Mjekësor i Kompleksit Spitalor Prof. Fabian Cenko, dekanët e UKZKM, mjekë dhe profesorë.

Në takimin e mirëseardhjes të organizuar në sallën e Senatit të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ministri Schillaci dëgjoi nga Rectori i UKZKM Prof. Leonardo Palombi për punën e palodhur që kryhet në Kampusin Spitalor dhe Universitar, me qëllim ruajtjen e standardeve më të mira të shërbimit shëndetësor dhe arsimit evropian. Vizitori i çmuar dhe i rëndësishëm përgëzoi drejtuesit e UKZKM për iniciativën e ngritjes

në këto nivele të Spitalit dhe Universitetit Katolik që sot, tha ministri italian, janë kthyer në një pikë referimi për Tiranën dhe Shqipërinë.

Ministri italian u nderua nga Presidenti i Fondacionit ZKM fr. Ruggero Valentini me Medalionin e Shenjtes shqiptare Nënë Tereza, e cila ka bekuar të gjithë ata që kontribuojnë për Spitalin Katolik të Tiranës.

Me pas delegacioni vizitoi ambientet e brendshme të Spitalit Katolik, duke u njohur me standardet dhe kushtet e shërbimit që u vlerësuan nga Ministri italian i Shëndetësisë Prof. Orazio Schillaci të niveleve konkurruese me Bashkimin Evropian.

Vijon nga fq 1



e tij, pavarësisht vështirësive dhe ai do të mbetet baba i familjes së tij, i popullit të Kosovës dhe modeli i njeriut që udhëhoqi me paqe dhe dialog. Rectori i UKZKM **Prof. Leonardo Palombi** Palombi tha se në kohët e sotme mesazhi i Presidentit Rugova është aktual. Zgjedhëm një Të Drejtë, tha Rectori që tregon se dialogu dhe paqja është vendimi i duhur.

Ambasadori i Republikës së Kosovës SH.T Skënder Durmishi tha gjatë takimit të posaçëm se ndihej i nderuar për këtë ngjarje dhe shprehu mirënjohjen ndaj Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë dhe Universitetit Katolik për këtë vendim që është, tha ambasadori Durmishi, një gjest i rëndësishëm për kujtimin e Presidentit të Parë të Kosovës.

Dom Gjergj Meta President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë tha se Rugova ndërtoi me modelin e tij një narrativë politike që nuk e ka ndërtuar askush tjetër deri më sot.

Emri i Ibrahim Rugovës u zgjodh me votim të fshehtë gjatë muajit Janar të këtij viti dhe pjesë e procesit të votimit ishin studentë dhe vullnetarë të UKZKM që treguan gjatë ceremonisë mbresat e tyre dhe vlerësimin për të çuar përpara trashëgiminë e Presidentit Rugova.

<https://it.gariwo.net/gallerie-fotografiche/proclamazione-del-giusto-all-universita-nostra-signora-del-buon-consiglio-di-tirana-28383.html>

Prezenca e një përfaqësuesi të Shtetit italian në këtë Institucion është një nder dhe gëzim. Falënderojmë në veçanti Z. Ministër, pasi Fondacioni ZKM që është një subjekt i ligjit shqiptar, përfiton një kontribut të pazëvendësueshëm ndërkombëtar dhe mbi të gjitha italian. Është pikërisht kjo karakteristikë që e bën Fondacionin një realitet të vlerësuar dhe që ngjall konsensus të gjerë në mesin e popullatës. Prezenca juaj Ministër Schillaci është shpërblim i punës tonë të realizuar krah për krah mes italianëve dhe shqiptarëve. Nuk po ndalem te lidhjet e thella dhe të njohura mes Italisë dhe Tokës së Shqiponjave. Fondacioni ZKM është realiteti më domethënës i bashkëpunimit midis dy vendeve, një realitet që gjeneron kulturë dhe kujdes, bashkëpunim dhe zhvillim, pra, për të ardhmen. Do të doja të theksoja tre aspekte.

I pari: në ditët e sotme ka turbulencë në marrëdhëniet midis shteteve. Ka një tendencë në rritje në Evropë dhe më gjerë për t'i bërë gjërat vetë ose akoma më keq, për t'u kujdesur vetëm për interesat e veta. Megjithatë, momentet historike më emocionuese të tetëdhjetë viteve të fundit kanë qenë ato në të cilat shtetet kanë hequr dorë nga një pjesë e sovranitetit të tyre për të promovuar një të mirë më të madhe. Këtë gjë na e mëson rasti i procesit të mundimshëm dhe

të veçantë të krijimit të Bashkimit Evropian. Modeli i jashtëzakonshëm spitalor dhe universitar i krijuar këtu në Tiranë është gjithashtu në po këtë drejtim: Italia solli këtu njohuritë e veta akademike pa i imponuar ato, por duke i ofruar për një kontribut në rritje të Shqipërisë. Shqipëria nga ana e saj ka mirëpritur një model të ndryshëm nga i veti duke promovuar kështu integrimin e saj. Diplomati e lëshuara nga UKZKM në bashkëpunim me universitetet italiane e kanë sjellë Shqipërinë në Evropë prej njëzet vjetësh tashmë, ndërkohë që nuk është ende anëtare e Bashkimit Evropian.

Aspekti i dytë, modeli i realizuar me Universitetet shtetërore të Romës, Milanos, Barit, Firences, Bolonjës, ka sjellë në një tokë le të themi neutrale, bashkëjetesën e përvojave të shumta, pasi këtu mund të gjejmë njëkohësisht botën private dhe shtetërore, vizionin fetar dhe laik, ndjeshmërinë e krishterë dhe myslimane, shpirtin sipërmarrës dhe konotacionin jofitimprurës të Fondacionit. Do të doja të nënvizoja natyrën jofitimprurëse të Organizatës sonë e cila frymëzohet nga një traditë civile dhe fetare e rrënjësuar thellë në Itali, shtet i cili ka ligjin më të mirë në botë për Sektorin e Tretë. Sektori i Tretë nuk është i privatit apo publikut, por paraqet mënyrën më të mirë të një aspirote solidariteti që nuk përjashton asnjë kulturë. Shqipëria, e cila ka

gjithashtu një traditë shembullore të bashkëjetesës dhe tolerancës ka nevojë për një përvojë të tillë, e cila sjell stimuj të rinj për të ecur drejt integritit të plotë dhe të frytshëm me Evropën dhe pjesën tjetër të botës nga ku ishte përjashtuar prej dekadash.

Së fundmi, aspekti i tretë dhe i fundit që sigurisht është më i përzemërt për ju si Ministër i Shëndetësisë. Këtu në Kompleksin spitalor dhe universitar të Tiranës më në fund është bërë realitet spitali i ëndërruar nga Nënë Tereza, i cili iu besua për t'u ndërtuar dhe menaxhuar Kongregatës së Bijve të Zojës së Papërlyer, e themeluar në Romë në vitin 1857 nga laiku i shuguruar, infermieri, i Lumi Luigi Monti. Jemi përballë një sfide të madhe për ta çuar përpara këtë projekt duke filluar nga qëndrueshmëria e tij ekonomike. Shteti shqiptar siguroi tokën ku pa fonde publike ndërtuam strukturën që po vizitoni sot. Kjo është bërë e mundur falë përkushtimit të shumë bashkëpunëtorëve italianë dhe shqiptarë, pjesëmarrjes së familjeve që mbështesin fëmijët e tyre që janë studentë në programet tona, besimit të pacientëve që çdo ditë e më shumë vijnë për të kërkuar shërbime shëndetësore. Shuma që ata paguajnë për shërbimet është tërësisht e destinuar për Spitalin, për rritjen cilësore dhe sasiore të veprimtarisë së tij.

Prandaj jemi duke promovuar **një formë të gjerë të pjesëmarrjes kolektive** për t'u kujdesur për një të mirë të përbashkët, atë të shëndetit të qytetarëve, të cilët janë të vetëdijshëm për kufizimet që rrjedhin nga një sistem shëndetësor lokal ende pa marrëveshje, i cili për më tepër na ishte siguruar në vitet e kaluara. Kjo është gjithashtu një fushë në të cilën do të duhet të punojmë për të çuar vendin drejt një sistemi shëndetësor më të përgatitur. Ju falënderojmë për vizitën tuaj: është një gjest i çmuar dhe domethënës, i cili na jep besim dhe na inkurajon.

04

KRESHMA DHE RAMAZAN MBAHEN NË TË NJËJTËN PERIUDHË: NJË MUNDËSI

Rastësi që ndihmojnë

Këtë vit mbajtja e Kreshmës dhe Ramazanit që janë kohë të shenjta për të krishterët dhe myslimanët përkojnë në të njëjtën periudhë. “Një afërsi në kalendarin shpirtëror” që do të thotë “një mundësi unike për të ecur krah për krah në një rrugëtim të përbashkët pastrimi shpirtëror, lutjeje dhe bamirësie”, thuhet në mesazhin që Dikasteri për Dialogun Ndërfetar u dërgon myslimanëve në mbarë botën për muajin e Ramazanit. “Këtë vit duam të reflektojmë jo vetëm mbi çfarë mund të bëjmë së bashku për të “jetuar një jetë më të mirë”, por mbi të gjitha mbi çfarë duam të bëhemi së bashku, si të krishterë dhe myslimanë, në një botë në kërkim të shpresës, thuhet në mesazh. “Duam të jemi bashkëpunëtorë të thjeshtë për një botë më të mirë apo vëllezër e motra të vërtetë që dëshmojmë bashkërisht miqësinë e Zotit me gjithë njerëzimin?” Dikasteri i drejtuar nga kardinali George Koovakad tregon se “besimi ynë në Zot është një thesar që na bashkon, përtej dallimeve tona”, duke shtuar se në një botë të karakterizuar nga padrejtësia, konfliktet dhe pasiguria për të ardhmen, thirrja jonë e përbashkët nënkupton shumë më tepër se praktikatat e ngjashme shpirtërore. Bota jonë ka nevojë për vëllazëri dhe dialog të mirëfilltë”.



Së bashku, myslimanët dhe të krishterët mund të jenë dëshmitarë të kësaj shprese, me bindjen se miqësia është e mundur pavarësisht peshës së historisë dhe ideologjive që na fusin në kurth.” Sipas Dikasterit të Vatikanit, “sfida është të ndërtojmë përmes dialogut një të ardhme të përbashkët, të bazuar në vëllazëri. Nuk duam thjesht të bashkekzistojmë; duam të jetojmë së bashku në respekt të sinqertë dhe të ndërsjellë.”

05

FILLON NGA ZKM


Ambasadori i ri Indian

Pak ditë pas mbërritjes së ambasadorit indian në Tiranë, më datë 19 janar ai bëri vizitën e tij të parë zyrtare në Shqipëri në

Ambasadori u takua me Rektorin e Universitetit, Prof. Palombi dhe me drejtorin e përgjithshëm të spitalit z. Poggi. Ai shprehu interes të



grupi mjekësh vendas dhe italianë që punojnë duke bashkëpunuar. Gjatë pritjes u dallua veçanërisht At Binu, administrator i Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” që së bashku me At Anish, fr. Robin dhe fr. Githjn përbëjnë një grup të vogël njerëzish fetarë indianë të përfshirë në Fondacion si punonjës apo studentë.



Fondacionin Zoja e Këshillit të Mirë. Ambasadori i Republikës së Indisë, **z. Ravindra Prasad Jaiswal**, kreu i zyrës diplomatike të hapur së fundmi në atdheun e shqiptonjave pranoi me kënaqësi ftesën e Presidentit të Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë fr. Ruggero Valentini për të vizituar Universitetin dhe Spitalin Katolik.

madh për aktivitetet akademike, të karakterizuara nga bashkëpunimi i ngushtë me Universitetet italiane që u mundësojnë studentëve të marrin tituj studimi që janë të vlefshëm në BE. Vizita në Spitalin Katolik ZKM ishte një mundësi për t’u njohur me cilësinë e strukturës shëndetësore falë pajisjeve mjekësore moderne dhe një

Ambasadori vlerësoi në mënyrë të veçantë dy figura që ndihmuan në hapat e parë të Fondacionit: Nënë Tereza e Kalkutës, e cila kishte inkurajuar ndërtimin e Spitalit dhe nuncin apostolik Ivan Dias, i cili kishte punuar në mënyrë aktive për ardhjen në Shqipëri të besimtarëve të Komunitetit montian.

Vetëm pak pas Ditës Ndërkombëtare të vajzave dhe grave në Aula Magna në UKZKM u promovua Plan i Barazisë Gjinore, i cili u prezantua nga **Prof. Ersilia Buonomo**, e Deleguara e Rektorit për Planin e Barazisë Gjinore. Ky është një dokument i rëndësishëm për kohën kur vjen, tha Rektori **Prof. Leonardo Palombi**, pasi sipas tij sot bota ka nevojë për një brez të ri që të kuptojë sa e rëndësishme është bashkëjetesa gjinore, sintonia e mbrojtjes së të drejtave të gjithkujt, për ndërtimin e një shoqërie më të mirë. E ftuar në këtë takim me një audiencë të lartë Prof. Anila Godo tha se barazia gjinore është më shumë se një e drejtë njerëzore.



Zj. Anila Godo solli shembuj që mbështesin arsimin dhe edukimin e vazhdueshëm si garanci për një shoqëri më të drejtë. Dhjetra student, vajza e djem, u bashkuan në "Aula Magna" për të ndjekur këtë prezantim ambicioz, të hollësishëm, kurajoz për objektivat që afrojnë standardet më të mira në UKZKM. Plan i 3 vjeçar u përgëzua nga të gjithë folësit në takim.

Dekani i Fakultetit të Mjekësisë **Prof. Guido Macchiarelli** tha se propozimi i këtij plani si një mekanizëm zhvillimi demokratik është një hap i guximshëm drejt respektit që të rinjtë duhet të kenë ndaj njëri-tjetrit. Profesoresha Ersilia Buonomo tha se për këtë dokument është punuar prej 8 muajsh, nga një grup i dedikuar, me qëllim reduktimin e asimetrive që krijohen mes gjinive, në një kohë kur në shoqëri të zhvilluara, tha ajo, ka një protagonizëm në rritje të vajzave e grave. Ky plan tha Prof. Ersilia Buonomo është i hapur ndaj të gjithëve për të bashkëpunuar. UKZKM sjell për herë të parë një plan trevjeçar që përcakton strategjinë për të promovuar kulturën e barazisë së gjinive dhe për të ulur pabarazitë, duke vlerësuar diversitetin.



Prof.ssa Ersilia Buonomo e deleguara e Rektorit për Planin e Barazisë Gjinore prezantoi planin që është në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe me Drejtorinë e Përgjithshme për Kërkimin dhe Inovacionin të Komisionit Evropian. Si pjesë e kësaj ngjarjeje është prezantimi i masave dhe i kontributeve edhe për personat me aftësi të kufizuara dhe angazhimin e tyre social duke përmbyshur një nga kërkesat e për të aksesuar fondet e kërkimit Horizon Europe.

Pas prezantimit të kësaj strategjie u shfaq filmi "C'è ancora domani" i Paola Cortellesi.

UKZKM u jep me këtë strategji brezave të rinj një qasje gjithëpërfshirëse, pa paragjykime dhe stereotipe. Më këtë plan Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" rrit prezencën e tij multikulturore që mirëpret komunitete të ndryshme, të cilat dallohen edhe nga pikëpamja gjuhësore dhe fetare. Prandaj ky plan synon të mbledhë raste dhe diversitete të shumta si një sfidë autentike për realizimin e plotë të multikulturalizmit.

Ne besojmë se është një rast dhe mundësi e mirë për çdo student dhe pedagog për shkëmbim dhe koordinim të ndërsjellë mbi parimet e një akademie universale që synon të kontribuojë në rritjen e njerëzve që mbartin vlera universale.



VLERAT E EVROPËS NË THEMEL TË HARMONISË DHE TRADITËS

Zhvillimi i qëndrueshëm



Botimi i librit të titulluar “Kultura e zhvillimit të qëndrueshëm për komunitetet gjithëpërfshirëse: mjetet metodologjike për vizione të reja” bashkoi në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” në Aula Magna ekspertë, profesorë dhe studentë, duke dhënë një kontribut të shtuar në njohjen e studimeve të reja të kësaj fushe. Në nisje të këtij takimi Rectori i UKZKM **Prof. Leonardo Palombi** pasi mirëpriti miqtë dhe të ftuarit tha se përse është e rëndësishme të flasim sot për këtë botim. Sipas Rectorit Palombi sekreti qëndron tek mbajtja e Evropës të qëndrueshme, në harmoni me vlerat njerëzore dhe zhvillimore dhe ky libër ofron pikërisht

universitet multidisiplinor që ofron kërkimin shkencor dhe ky botim është një ftesë për kërkuesit e rinj që të gjejnë metoda të reja profesionale



hedhura në libër. Profesor **Antonio Felice Uricchio** që mban detyrën e Presidentit të Agjencisë Kombëtare italiane të Vlerësimit të Sistemit Universitar dhe Kërkimit Shkencor (ANVUR) dhe ish-Rectori i Universitetit të Studimeve të Barit “Aldo Moro”, pasi falenderoi drejtuesit e UKZKM për këtë promovim, tha se tema e qëndrueshmërisë është temë e përfshirjes së familjeve, qyteteve, komuniteteve duke dhënë një



në punën e tyre. Zv Rectori Hajdëri solli në vëmendje fjalët e Atit të Shenjtë Papa Françeskut për rolin e zhillimit të qëndrueshëm klimatik, urban e njerëzor. Sipas Prof. Hajdërit ky libër u shërben njerëzve që merren me komunitetet dhe zhillimin tërësor



një këvndvështrim që pasuron njohuritë tona. Në shekujt e kaluar, por edhe tani, tha Prof. Palombi Evropa ka kaluar ngjarje të forta, të cilat kanë patur ndikimin e tyre edhe në botë. Në një sfond të ndryshimeve të forta demografike që kanë ndodhur, vëren Rectori Palombi, rritet ekonomia dhe teknologjia dhe dalin në pah panorama të ndryshme që lidhen me gjeopolitikën. Ky libër hedh idetë sesi mund t'i shohim qytetet e të ardhmes, duke përqafuar atë model që Evropa ofron sot, bashkëjetesën.

Nënkryetari i bashkisë së Tiranës **Andi Seferi** tha se libri është një botim i çmuar që shërben si guidë edhe për drejtuesit e qeverisjes vendore, duke na ndihmuar, tha ai, të kuptojmë më shumë për një zhvillim urban të qëndrueshëm.

Zv. Rectori i UKZKM **Prof. Edmond Hajdëri** tha se është i gëzuar që Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” bëhet promovues i një botimi të tillë që ofron shumë njohuri për sfidën e zhillimit të qëndrueshëm. UKZKM, tha Prof. Hajdëri, është një



të tyre, por edhe studentëve sepse ata duhet të kenë parasysh interesin publik dhe ndërtimin e projekteve që ndihmojnë dhe nuk krijojnë konflikte.

Dekani i Fakultetit të Ekonomisë në UKZKM **Vitorio Teotonico** ndau me audiencën eksperiencën e njohjes së tij me një nga botuesit e këtij libri, profesor Uricchion, duke vlerësuar qartësinë e tij në idetë e



vizion të qartë të të ardhmes. Të rinjtë dhe kultura, tha ai, luajnë një rol të rëndësishëm, ndaj duke respektuar të drerjtat e natyrës, marrim më të mirën për një të ardhme të qëndrueshme. Ky botim



është një eksplorim i guximshëm i pasojave të pjesëmarrjes dhe kujdesit ndaj komuniteteve, të mirave që sjell trashëgimia kulturore dhe natyrore dhe ndikimit që ka në komunitet zhvillimi i territorit. Takimi u përshëndet edhe nga **Prof. Mario Aulenta, Profesor i Asociuar i te Drejtes** Tatimore në Universitetin e Studimeve të Barit “Aldo Moro”.

08

STUDIO NË QYTETET EVROPIANE

Erasmus+

Të dashur studentë, Kemi kënaqësinë t'ju informojmë se në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për shkëmbim ndërkombëtar për studime për vitin e ardhshëm akademik 2025/2026 (shih <https://www.unizkm.al/categories/bandi/posts>). Kjo është një mundësi për mos e humbur për të pasuruar rrugëtimin tuaj arsimor me një përvojë ndërkombëtare në një nga destinacionet e mëposhtme:

- Universiteti i Parmës
- Universiteti Katolik i Valencias San Vicente Martir
- Universiteti Ekonomik i Krakovit
- Universiteti i Romës, Tor Vergata
- Universiteti i Chieti-Pescara "G. D'Annunzio"
- Universiteti i Firences
- Universiteti i Foxhias

Afati i fundit për aplikime

31 Mars

2025

ora 16:00



09

PROMOVIMI I UNIVERSITETIT

Work & Study

Lezha ishte ndalesa jonë

LUKZKM po bëhet gati për një nga periudhat më emocionuese atë të mikpritjes së studentëve të ardhshëm. Ndaj sot në qytetin e Besëlidhjes së Heroit tonë Kombëtar koordinatorët tanë shpjeguan me detaje çdo informacion që ndihmon maturanët të kuptojnë më shumë për programet tona të studimit. Edhe pak ditë dhe kampusi i UKZKM



do të gumëzhijë si çdo vit nga qindra të rinj që do t'i njohim për herë të parë në "Open Day".

Jemi në Shkodër, në qytetin e kulturës dhe dashurisë për artin e dijen. Të rinj të apasionuar për programet tona të studimit në



arkitekturë, ekonomi, farmaci infirmieri, fizioterapi, odontoiatri dhe mjeksi, të gjithë me pasionin për të qenë nesër kontribuesit e zhvillimit të familjeve dhe qytetit të tyre. Faleminderit Shkodra që e mikprit standën e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" çdo vit me bujari e interes. foto

Tungjatjeta nga qyteti i mikpritjes Kukësi!

Stenda e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" qëndroi në zemër të qytetit verior dhe mikriti dhjetra maturanë plot ëndrra dhe pasion për të ardhmen. Koordinatorët dhe stafi ynë u shpjegoi me hollësi programet e studimit, duke ju hapur



një portë të re që i sjell jo vetëm në kampusin tonë në Tiranë, por u jep në duar diplomat e njohura në të gjitha vendet e BE-së. Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" nisi një udhëtim që sjell emocion e dobi për maturanët e Shqipërisë. Rrugëtimin tonë e filluam nga **Burreli e Dibra**, nga dy zona

me tradita historike që kanë dhënë shumë për historinë tonë.

Stafi ynë i përkushtuar u shpjegoi në standat e dedikuara të rinjve programet tona të studimit dhe mundësitë e vërteta që përfitojnë duke zgjedhur UKZKM.

Jemi kudo, jemi për edukimin, jemi një hap më pranë Evropës! foto Sot ishim në Panairin Studiuarë in Italia. @iictirana Kjo ngjarje është një urë e konsoliduar prej vitesh në të cilin UKZKM prezantohet me krenari për programet e studimit të standardeve më të mira evropiane. Ditët po afrojnë kohën e zgjedhjes suaj të dashur maturanë, ndaj ju ftojmë të na kërkon në faqen



tonë zyrtare ukzkm.al dhe në rrjetet sociale për të përqafuar rrugëtimin e sigurtë të jetës tuaj profesionale.



UKZKM u prezantoi të rinjve një portë të re mundësish që të përzgjedhin me mençuri universtetin e duhur.

NGA PROJEKTI TE REALIZIMI I STUDIMIT TË FIZIBILITETIT PËR RESTAURIMIN DHE RIMËKËMBJEN E TEATRIT TË AKADEMISË SË ARTEVE TË TIRANËS

Vepër e firmosur nga Fabio Capanni, Riccardo Renzi, Andia Guga

Në bibliotekën e UKZKM studentët dhe të apasionuarit e Arkitekturës do të gjejnë së fundmi një botim të ri, mjaft të vyer për plotësimin dhe rritjen e njohurive në këtë fushë që bashkon artin dhe shkencat e sakta. Punimi që mban firmat e Fabio Capanni, Riccardo Renzi, Andia Guga nga Fakulteti i Arkitekturës pranë Universiteti të Firences dhe të "Zoja e Këshillit të Mirë" në Tiranë, paraqet një punë kërkimore ndërdisiplinore mbi Projektimin Arkitekturor të kryer nga një grup profesorësh dhe kërkuesish shkencorë të Departamentit të Arkitekturës të Universitetit të Firences, me titull "Studimi i Fizibilitetit për Restaurimin dhe Rimëkëmbjen e Godinës së Teatrit të Universitetit të Arteve në Tiranë", i nisur në vitin 2019 dhe së fundmi i përfunduar, realizuar dhe zbatuar. Universiteti i Arkitekturës në Firence ka një marrëdhënie të qëndrueshme me qytetin e Tiranës, jo vetëm për shkak të diplomës së dyfishtë me UKZKM, por edhe sepse shumë profesorë të Universitetit të Firences janë të angazhuar në leksione dhe laboratorë pranë universitetit tonë.


Gjithashtu, në Departamentin e Arkitekturës të Firences janë duke u zhvilluar kërkime mbi arkitekturën dhe planifikimin urban të shekullit të 20-të në Shqipëri. Këto kërkime janë zhvilluar gjatë dekadës së fundit në kuadër të programeve të doktoratës në Projektim Arkitekturor dhe Urban dhe ende disa prej tyre fokusohen tek arkitektët italianë që projektuan dhe ndërtuan në periudhën 1920-1945 në Shqipëri, me vëmendje të veçantë ndaj krijimit të Zyrës Qëndrore të Ndërtimit dhe të Urbanistikës Shqiptare. Teatri i Universitetit të Arteve në Tiranë konsiderohet si një nga shembujt më domethënës të arkitekturës italiane të gjysmës së parë të shekullit të kaluar dhe rëndësia e tij konsiderohet parësore në

panoramën arkitekturore shqiptare. Objektivi kryesor i studimit ishte identifikimi i metodologjive që do të adoptoheshin për restaurimin e sallës së teatrit dhe sistemet e saj teknike dhe përputhshmërinë rregullatore, me qëllim ruajtjen e vlerave historike, kulturore dhe arkitekturore të ndërtesës.

Studimet kanë investuar në aspekte të ndryshme që janë domosdoshmërisht të lidhura me njëra-tjetrën: nga ato urbanistike dhe rregullatore deri te ato historike dhe arkitekturore; nga ato strukturore dhe teknologjike tek ato që kanë të bëjnë me akustikën; dhe deri te punimet dhe arredimet të cilat në këtë rast konkret kanë një vlerë të konsiderueshme dhe kontribuojnë në përcaktimin e vlerës dhe karakterit të veçantë të ndërtesës.

Ruajtja është konsideruar si një parim udhëzues. Krahas ndërgjegjësimit për vlerën objektive të godinës, kjo diktohej edhe nga legjislacioni aktual, i cili në kuadër të Rregullores së Urbanistikës së Tiranës, e përcakton teatrin si një pasuri të mbrojtur nga Ministria e Kulturës, në varësi të Institutit të Monumenteve të Kulturës. Uniteti stilistik i ndërtesës, i konstatuar në përbërjen e përgjithshme të dekorimit dhe arredimit, është konsideruar si një nga vlerat kyçe rreth të cilave do të zhvillohej Studimi i Fizibilitetit.

Megjithëse gjendja aktuale e ndërtesës korrespondon në thelb me projektin origjinal të hartuar nga Gherardo Bosio dhe bashkëpunëtorët në 1939, me kalimin e viteve disa pjesë kanë pësuar ndryshime që e kanë bërë më të vështirë identifikimin e situatës dhe identitetin e projektit origjinal. Nga viti 1943 deri në vitin 2020, zona përreth Tiranës ka ndryshuar ndjeshëm sa i përket strukturës së vendbanimeve të zonës monumentale të qytetit.






Kërkimi i Iris Sulaj mbi acidin ursodeoksikolik në Universitetin e Barit "Aldo Moro".

Kemi kënaqësinë të tregojmë përvojën e jashtëzakonshme kërkimore të studentes Iris Sulaj, e cila së fundmi kreu një studim shumë domethënës në Laboratorët Kërkimore të Grupit të Teknologjisë Farmaceutike dhe Rregullator të Barnave (PhartecoLab) të Departamentit të Farmacisë – Shkencave Farmaceutike të Universitetit të Barit Aldo Moro. Nën drejtimin e profesorit Nunzio Denora, Iris e fokusoi kërkimin e saj në zhvillimin e një formulimi inovativ të lëngshëm oral të bazuar në acidin ursodeoksikolik (UDCA), një acid biliar sekondar i njohur për përdorimin e tij terapeutik



në trajtimin e sëmundjeve të mëlçisë. Historia e UDCA daton në mjekësinë e lashtë kineze, ku fillimisht u përdor si një përbërës i një preparati pluhur të marrë

nga biliari i ariut adult. Sot, UDCA është e njohur për efektet e saj terapeutike në trajtimin e sëmundjeve të shumta pediatrike të mëlçisë, duke përfshirë kolestatën dhe atrezinën biliare. Zhvillimi i një preparati të lëngshëm mund të japë një zgjidhje ideale në klinikat e



fëmijëve. Qëllimi i kërkimit të Irisit ishte të krijonte një formulim të lëngshëm oral të tretshëm të UDCA, duke përdorur bazën inovative Wagner, një mjet i gatshëm për përdorim i zhvilluar në bashkëpunim me Laboratorët Kërkimore Farmalabor. Kjo bazë u përdor për të optimizuar tretshmërinë e UDCA dhe për të përmirësuar konsistencën dhe lehtësinë e përgatitjes, duke siguruar që formulimi të plotësonte standardet e kërkuara të sigurisë, efikasitetit dhe cilësisë për përdorim në pediatri. Nëpërmjet studimeve rigorozë të paraformulimit, Iris ka demonstruar se baza Wagner

është në gjendje të tresë UDCA deri në përqendrim prej 30 mg/mL në një temperaturë prej 25°C. Studimet e stabilitetit të kryera në kushte të ndryshme magazinimi (4–8°C, 25°C dhe 40°C) për një periudhë prej dy muajsh kanë konfirmuar se preparati mbetet i qëndrueshëm kimikisht dhe fizikisht, duke e bërë atë një kandidat ideal për përdorim pediatrik. Puna e Irisit përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të trajtimeve të personalizuar dhe të aksesueshme për pacientët pediatrikë, veçanërisht në fushën e sëmundjeve të mëlçisë në fëmijëri. Ky mjekim i jashtëzakonshëm i



lëngshëm ofron një zgjidhje të thjeshtë, efektive dhe të qëndrueshme, e cila mund të përmirësojë ndjeshëm rezultatet terapeutike, duke iu përgjigjur nevojave specifike të pacientëve më të brishtë.

Ne i shprehim urimet tona të përzemërta Irisit për arritjen e saj të jashtëzakonshme dhe kontributin e saj të rëndësishëm në avancimin e kërkimit farmaceutik. Puna e saj është një dëshmi e fuqisë së inovacionit dhe përkushtimit për të përmirësuar cilësinë e jetës së pacientëve pediatrikë në nivel global.

Nga data 13 mars deri më 11 Prill 2025, 25 studentë të programit të studimit në Arkitekturë nga Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", nga viti i 4-të dhe i 5-të do të jenë mysafirë në Universitetin e Firences si pjesë e marrëveshjes së diplomës së dyfishtë. Ky shkëmbim, i cili zhvillohet çdo vit u ofron studentëve mundësinë për të marrë pjesë në programe të përbashkëta me kolegët e tyre fiorentinë duke pasuruar studimet e tyre me përvoja dhe qasje të reja. Gjatë qëndrimit të tyre studentët do të kenë mundësinë të kryejnë inspektime mbi temat e projektit në qytetin e Firences, kryesisht në kurset e Arkitekturës dhe Labororit të Qytetit dhe Labororit të Arkitekturës dhe Mjedisit, ku do të thellohen në dinamikat që lidhen me dizajnin urban dhe të qëndrueshëm.



ZHVILLIMI VJEN NGA KULTURA E PUNËS

Mundësitë e formimit profesional në Shqipëri

Programet e reja formimi po hapen krahas iniciativave universitare tashmë të konsoliduara: Fondacioni ZKM ka krijuar së fundmi një degë aktiviteti nëpërmjet Qendrës së Formimit Atë Monti, e cila do të fillojë të funksionojë në zyrat e Shkodrës dhe Elbasanit.

Nën Drejtimin e **Dr. Luigi Gjergji**, Qendra është duke organizuar hapjen e programeve për operator social-shëndetësor, të cilat do të pasohen nga programe të tjera në fusha të ndryshme profesionale si programues IT.

Për këtë arsye, në datat 20-21 janar, disa operatorë të ENAIP Lombardia (një organ i rëndësishëm trajnimi italian) erdhën në Tiranë për të verifikuar mundësitë për të promovuar së bashku disa aktivitete formimi afatshkurtra. Në këtë kontekst u realizua edhe vizita e presidentit fr. Ruggero Valentini, i shoqëruar nga drejtori i Qendrës, në Rajonin Veneto, me të cilin janë hapur kanale për nisma të reja. Së fundmi, kontaktet janë të hapura me subjekte të tjera formimi që synojnë të ofrojnë kurse dhe praktika profesionale.



FORMIM I VAZHDUESHËM NË ODONTOIATRI

Trajnim dyditor pranë Klinikës Stomatologjike

Trajnim dyditor pranë Klinikës së Stomatologjisë në Kampusin e Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”. Gjatë muajit shkurt pranë Klinikës së Stomatologjisë në Kampusin e Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” u organizua trajnimi dyditor në Pedodonti, gjatë të cilit ekspertë të fushës dhanë njohuri teorike dhe praktike të çmuara. Dy mjeket e njohura të specializuara në Pedodonti nga Universiteti i Padovës, **Dr. Dejed Kokici** dhe **Dr. Anna Franco** ndanë eksperiencën e tyre të vyer në kujdesin ndaj pacientëve të vegjël. Doktorësh Kokici është ish-studente e Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” dhe sot shijon shpërblimin e sakrificës së saj që me sukses përmbushi standardet akademike më të mira të UKZKM, si një lider në fushën e edukimit prej vitesh.

Pjesëmarrësit patën mundësi gjatë trajnimit të thellonin njohuritë e tyre, duke u fokusuar tek trajtimi konservativ i kanalit të rrënjës së dhëmbëve të qumështit dhe tek përdorimi i sedacionit koshient, një teknikë që siguron një përvijë më të rehatshme dhe pa stres për fëmijët gjatë trajtimeve dentare.

Vëmendja e drejtuesve të Klinikës së Stomatologjisë në Kampusin e Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” është drejtuar shpesh në edukimin e të vegjëlve për një higjienë të kujdesshme gjatë fëmijërisë së tyre.





Tre drejtuesit e *Societade Civil Nossa Senhora Aparecida* të Foz do Iguaçu (Brazil) mbërritën të dielën më 16 mars si të ftuar të Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë. Bëhet fjalë për presidentin At Raúl Sena Velez dhe dy nga bashkëpunëtorët e tij të ngushtë, **znj. Eva Aparecida Claudino Bonfim Cazal** dhe **z. Jackson Henrique Gatelli**.

Societade është një institucion jofitimprurës i promovuar nga komuniteti montian në qytetin brazilian në kufi me Argjentinën dhe Paraguajin, i njohur për ujëvarat e tij të bukura. Ashtu si institucioni jonë në Tiranë, ka mbi tridhjetë vjet që operon në fushën e shëndetësisë dhe arsimit. Për

këtë arsye synimi i vizitës ishte për njohja me njëri-tjetrin dhe shkëmbimi i kompetencave dhe projekteve. Brazili është një vend i madh në Amerikën Latine, i pasur mbi të gjitha me energji të reja të cilat për fat të keq i mungojnë sot Evropës.

Të ftuarit u pritën me shumë dashamirësi edhe nga Ambasadori i Brazilit në Shqipëri **Sh.T Joao Tabajara de Oliveira Jr.** dhe gruaja e tij **znj. Sandra Esteves Tabajara**. Gjatë vizitës ata arritën të dallojnë potencialin që ofron Universiteti ZKM për arsimimin e të rinjve nga Brazili.


PELEGRINAZH PËR JUBILEUN 200 VJEÇAR TË AT'MONTIT

23 Korrik - 6 Gusht 2025

Me rastin e dyqindvjetorit të lindjes dhe pagëzimit të të Lumit Luigi Maria Monti, ju ftojmë të merrni pjesë në një pelegrinazh të rëndësishëm, një rrugëtim besimi, zbulimi dhe vëllazërimi. Kjo eksperiencë unike do të na çojë nga Tirana në Milano dhe Romë, ku do të vizitojmë vendet e shenjta, do të marrim pjesë në Jubileun Rinor dhe do të nderojmë trashëgiminë e të Bekuarit Monti.

PROGRAMI

- 23 Korrik** Nisja nga Tirana për në Milano, mbërritja në Cantù
- 24 korrik** Festa e At Montit në Saronno
- 25 korrik:** Cammino Montiano – një rrugë e veçantë në gjurmët e Beato Monti
- 26 korrik** Vizitë në Milano, për të zbuluar trashëgiminë e tij të pasur kulturore dhe shpirtërore
- 27 korrik** Udhëtim nga Milano në Romë
- 29 korrik - 3 gusht** Pjesëmarrja në Jubileun Rinor në Romë
- 4-5 gusht** Vizita në të gjitha bazilikat kryesore të Romës dhe vendet e veçanta që lidhen me At Monti
- 6 Gusht** Kthimi në Tiranë



Informacione të rëndësishme

Kosto e udhëtimit: **€200**

Vende të limituara: **Vetëm për 15 vetë**

Per informacione na kontakto në email

opastorale.universitaria@unizkm.al

REGJISTROHU TANI!



Mimoza
Agastra

poezi

ORKIDE E BARDHË, IKONË E ARTË


Sa do të doja të rrija me veten !
Së paku vetëm sot!
T'ia thoja dy fjalë të dëshiruara e kaq të
munguara;
T' i flisja thjeshtë dhe qartë,
T'a shtrëngoja fort e t'i thoja që edhe atë e dua.
T'ia ndjeja rrahjet e trazuara të zemrës, pulsën e
dobët nga lodhja.
E bashkë me të t'ia fshija lotët e fshehura që
rrallë ia dallon në qepallë;
T'ia prekja duart e lodhura e t'a ngrohja me
frymën e mbetur, por të ngrohtë.
T'a ftoja të përhumbej në gjumin e ëndërruar,
aty ku ëngjëjt e dashuruar i qasen për t'ia
dhuruar prehje.
Aty ku liria si eliksir i harruar t'i shfaqet si për t'a
kujtuar:
-Mos u dorëzo!

T'a joshja që të thërriste fëmijërinë pranë e të
çmallej me të.
Të vishte, pse jo, pelerinën e ndezur femërore, të
hijeshohej,
të zbukurohej një herë së paku vetëm për veten
e saj.
Të pushonte e boshatisur,
pa asnjë mendim në kokën që ka magazinuar
gjithçka,
përveç vetes.
Të fliste me botën, qetësinë e pasionet e saj.
Vetëm kaq!
Mos po kërkon shumë?!
- dëgjova veten time të më fliste.
Mos u bëj egoiste!
Ç'përkëdhelesh?
Jooo, kështu s'të shkon!
Shiko, fëmijët po të thërrasin,
Bashkëshorti po të pret....

Shoqëria një kafe me ty ka rezervuar ka kaq vjet,
puna ka filluar...
Muzën e ke degdisur honeve pa kthim.
Shtëpia nga miqtë po zhurmon,
dikush telefonit ka kohë që tringëllimën s'ia ndal,
porta po troket...
Një zë u çorr nga jashtë shtëpisë duke të të thirrur
në mijëra emra.
Enët, rrobat, janë aty përgj, sa s'kanë gojë të çirren
për duart e tua,
e ti, akoma shtrirë?!

Unë vërtet të thashë që të dua, vetja ime,
po jo aq sa të harrosh të tjerët.
Kaq shumë prisje të të doja?
Po të tjerët ku i le?
Koha rend, ska më kohë...
Ngrihu !

Ti e di që pa ty bota ndalet.
Më duhet të them që vetëm kështu je e lumtur ti.
Si? - pyeta e dërmuar, e dyzuar.
Duke lumturuar të tjerët pra, ndryshe s' je grua.
Të lutem vazhdo të shkëlqesh,
të mbulosh botën me farën tënde të mirësisë.
Pa ty, botës i fiket drita.
Pa ty botës i shuhet dashuria.
Pa ty botës i shtohet ligësia.
Pa ty bota mbetet pa sy.
Pa ty bota është e shurdhët,
e pagojë, pa ndjeshmëri,
pa të ardhme!
Harroi thinjat e fshehura!
Leri të lulëzojnë si orkide të bardha!
Dhe rudhat ta zbukurojnë buzqeshjen,
si ikonë e artë!
Veten mos e harro!
Ndaj, ngrihu zonjë dhe lufto,
deri në lotin tënd të fundit!
Orkide e bardhë, ikonë e artë!



Loris Guri

telajo

Loris Guri vjen nga qyteti i Durrësit dhe është studente e vitit të parë në Arkitekturë pranë Universitetit Katolik "Zonja e Keshillit të Mirë".

Loris ka zhvilluar ndër vite pasionin e saj për artin pamor. Përmes punëve të ndryshme ajo synon të hedhë në telajo të bukurën. Loris ka marrë pjesë në konkurse arti, duke provuar veten dhe qëndrimin e saj artistik. Loris frymëzohet nga bota rreth saj dhe punon për të ndarë perspektivën e vet unike përmes artit.





UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO



Co-funded by the
European Union

LEZIONE
APERTA

Jean Monnet Module PHARM-EU

RESPONSABILITÀ del PRODUTTORE di FARMACI e DOVERE DI INFORMATIVA

Relatore
Prof. Claudio D'Alonzo
Università Cattolica "NSBC"

📅 **20 marzo 2025**

🕒 **12:00**

📍 **Aula B105**

UNIVERSITÀ CATTOLICA "NSBC"
Tirana-Albania



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO



Co-funded by the
European Union

Jean Monnet Module PHARM-EU

Tavola rotonda **FARMACOECONOMIA**

📅 **25 marzo 2025**

🕒 **11:00**

📍 **Aula B105**

UNIVERSITÀ CATTOLICA "NSBC"
Tirana-Albania



FESTA E FONDACIONIT ZKM

23 prill 2025

Meshë & Mbrëmje festive



Pelegrinazh në Shkodër

26 Prill 2025



X CONGRESSO DILLE

LINGUE, TERRITORI E CONTESTI:
LE POLITICHE LINGUISTICO-EDUCATIVE OGGI

22-24 MAGGIO 2025

Università Cattolica
"Nostra Signora del Buon Consiglio"
Tirana, Albania



UNIVERSITÀ CATTOLICA
"NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO"
CENTRO LINGUISTICO DI ATENEIO



Invio proposte abstract
entro il **20 gennaio 2025**

OPEN DAY UKZKM 2025

12 aprile 2025



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

ZKM PODCAST *Coming soon...*



Moderatrice: **MARINELA BRUNGA**

UNIVERSITÀ CATTOLICA NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO
PASTORALE GIOVANILE



**FONDAZIONE
NOSTRA SIGNORA
DEL BUON CONSIGLIO**

Dedicata all'educazione, dedicata alla salute

Tirana - Albania

VIA CRUCIS

UDHA E KRYQIT



Iniziamo il 7 Marzo 2025

(Per tutti i venerdì del periodo quaresimale)



16:30



**Partenza al Giardino dei Giusti
lungo l'Anello di Re Salomone**

UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO
TIRANA-ALBANIA



Chiedi la tua copia nella Biblioteca ZKM

